



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 12943 Prot.

Vlorë, më 15.08. 2024

PROJEKT VENDIM

Nr. ____ datë ____ 2024

“PËR VENDOSJEN E BUSTIT TË PATRIOTIT ISMAIL MEKATI NË FSHATIN DRITHAS”

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar neni 8, neni 9.1, pika 1.1/a dhe b, pika 1.7/b, neni 54 pika II, në Vendimin e Komisionit Këshillimor “Për Titujt Vendorë të Nderit” datë, 08.07.2024, në propozimin e Kryesisë së Fshatit Drithas datë, 26.06.2024 si dhe, në relacionin e paraqitur nga Administrata e Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Vlorë në mbledhjen e datës __.__.2024

VENDOSI:

1. Të miratojë vendosjen e bustit të patriotit Ismail Mekati në Fshatin Drithas, Njësia Administrative Shushicë, sipas planvendosjes së paraqitur nga Drejtoria e Urbanistikës, bashkëlidhur këtij projektvendimi.
2. Për zbatimin e këtij Projektvendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Vlorë,
3. Ky Vendim hyn në fuqi bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 55, pika 6.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 12843 Prot.

Vlorë, më 15.08. 2024

RELACION

MBI PROJEKTVENDIMIN

“PËR VENDOSJEN E BUSTIT TË PATRIOTIT ISMAIL MEKATI NË FSHATIN DRITHAS”

Para Këshillit të Bashkisë Vlorë

Të nderuar Këshilltarë!

Projektvendimi “Për vendosjen e Bustit të Patriotit Ismail Mekati në Fshatin Drithas” që ju paraqesim për miratim, lidhet me një figurë të shquar të historisë kombëtare ,gjatë viteve 1800,si bashkëluftëtar i Rrapo Hekalit, i shquar në luftat kundër okupimit Otoman. Ky projektvendim është propozim i Kryesisë së Fshatit Drithas, Njësia Administrative Shushicë i cili është miratuar edhe nga Komisioni Këshillimor i Titujve Vendorë të Nderit në mbledhjen e datës 08.07.2024.

Patrioti Ismail Mekati së bashku me bashkëluftëtarë të tjerë ka marrë pjesë në luftimet për mbrojtjen e Shkodrës dhe Ulqinit për mbrojtjen e territorit Shqiptar , nga pretendimet territoriale të shteteve shoviniste , në kufi me Shqipërinë. Përveç karrierës ushtarake ka kontribuar edhe për hapjen e shkollave të para shqipe. Gjithashtu pjestar të familjes , dy djemtë e tij kanë qënë bashkëluftëtarë të patriotëve të shquar si Zenel Gjoleka etj, dhe kanë marrë pjesë me armë në dorë në Luftën e Vlorës, të vitit 1920 kundër Italisë.

Nga propozuesit kërkohet të vendoset një përmendore, ndërsa Komisioni Këshillimor i Titujve Vendorë të Nderit, sygjeroi të jetë një bust i thjeshtë në Fshatin Drithas.

Nga sa më lart, si dhe në dokumentacionin bashkëngjitur këtij projektvendimi, propozojmë që Këshilli i Bashkisë të miratojë këtë projektvendim si një vlerësim për këtë figurë të shquar patriotike të Rrethit të Vlorës.

Ju faleminderit.



9904

24.06.2024.

Drithas më ---/---/-----

+

Kërkesë

Tema: Drejtuar Këshillit Bashkiak Vlorë

Lënda: Mbi vendosjen e një përmendorje në fshatit Drithas

Të nderuar këshilltar! Me anën e kësaj kërkesë kërkojmë nga ana juaj të na mundësoni dhënien e një ambjenti në fshatin Drithas për vendosjen e një përmendorje të patriotit Ismail Mekati. Duke u nisur nga aktiviteti i ngjeshur atdhetar në luftërat kundër Turqisë me kërkesën dhe të familjarëve, të cilët marrin përsipër të gjitha kostot financiare, ne si banorë të fshatit Drithas e ndiejmë si detyrim, që një figure kaq të shquar në lëmin patriotik dhe atdhetar ta vëndosim në panteonin e shqipëtarve të shquar. Patërioti Ismail Mekati i ra fati që bashkëpunoj me vigan të histories së re të Shqipëris. Ai bashkëpunoj me Ali Pashën në luftërat për mëvetësisë dhe i qëndroj besnik deri në fund të idealeve të saj. Gjithashtu Ai bashkëponoj si patëriot dhe luftëtar dhe me lidhjen për mbrojtjen e Shkodrës dhe Ulqinit duke u plagosur në luftime e sipër. Kontriboj në hapjen e shkollave shqip, bekoj të gjitha betejat kundër Turqisë Ai së bashku me djalin e tezes Rrapo Hekalin nuk reshtën betejat kurrë. Për këto dhe kontribute të tjera të shquara ne si fshat ndihemi krenar por dhe të obliguar që këtë personalitet ta kemi si pike referimi. Të dashur këshilltar ndihem I vlersuar dhe njëkohësisht i privilegjuar që në emër të këtij komuniteti unë si kryetar i fshatit ju drejtohem Juve me këtë kërkesë.

Ju faleminderit!

Kryetari I fshatit Drithas



